



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 76 datë 30.10. 2023

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 1.1 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”, dhe bën pjesë në ngastrën nr.98a me sipërfaqe 0.73 ha dhe 98b me sipërfaqe 0.37 ha në ekonominë pyjore Shosh 2-1.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, ku në mbledhjen e datës __. __. 2023 **Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:**

V E N D O S I:

1. Dhënien në përdorim të sipërfaqes në total 1.1 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, shëndetsore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”, dhe bën pjesë në ngastrën nr.98a me sipërfaqe 0.73 ha dhe 98b me sipërfaqe 0.37 ha në ekonomine pyjore Shosh 2-1, sipas listës së inventarit, shtojca nr.47 dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

2. Afati i dhënies me qera të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

K R Y E T A R

Ervis Shimaj


Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.11 2023



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija